



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 168**

**23 tetor**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 41, datë 10.10.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-1382(217), datë 3.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	7455
Vendim i GJK nr. 42, datë 10.10.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 562, datë 6.12.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	7460
Vendim i GJK nr. 43, datë 17.10.2013	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, të plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	7463

**VENDIM**  
**Nr. 41, datë 10.10.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtar e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtar e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 21.5.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 14 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Kliton Vaso, i përfaqësuar nga av. Gentian Mete, me prokurë të posaçme.

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** Banka Kombëtare e Greqisë, përfaqësuar nga av. Erinda Ballanca, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2012-1382(217), datë 3.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 2, 6, 13 të Kodit të Procedurës Civile.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit dhe mbrojtësit të tij, që kërkojnë pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të përfaqësuesit të subjektit të interesuar, që kërkojnë rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi ka punuar pranë Bankës Kombëtare të Greqisë, Dega Tiranë (*në vijim “NBG”*) nga data 12.7.2005, mbi bazën e kontratës së lidhur me shkrim, me afat të pacaktuar. Fillimisht, ai ka qenë në pozicionin e Drejtuesit të Degës Kryesore Tiranë, kurse pas datës 1.9.2007 në pozicionin e menaxherit të shitjeve, në Drejtorinë Administrative. Në datën 2.6.2008, NBG-ja i ka komunikuar atij zgjidhjen e kontratës së punës me efekt të menjëhershëm dhe largimin nga puna si rezultat i shkeljes së kushteve të kontratës dhe të normave të Kodit të Punës.

2. Për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt *“Detyrimin e të paditurit Bankës Kombëtare të Greqisë sh.a.-Dega Tiranë për të dëmshpërblyer paditësin Kliton Vaso me pagën e një viti pune, si rrjedhojë e zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënieve të punës; me dy paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës; si dhe me dy paga mujore për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9953, datë 18.11.2008, ka vendosur pranimin e padisë sipas objektit.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e paraqitur nga pala e paditur, NBG, me vendimin nr. 154, datë 3.2.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë si të papabuar në ligj dhe prova.

4. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore rekursin e paraqitur nga kërkuesi, me vendimin nr. 00-2012-1382, datë 3.5.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit.



## II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në datën 30.1.2013, me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar mosrespektimin e parimit të paanshmërisë, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

5.1 Procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në shkelje të nenit 72, pika 3 të KPC-së, që parashikon se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes kur ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve ose njërin prej përfaqësuesve.

5.2 Në kundërshtim me kërkesat e nenit 73 të KPC-së, gjyqtarja M.F. nuk i ka paraqitur kryetarit të Gjykatës së Lartë kërkesë për heqje dorë, por ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes edhe pse ndodhej në kushtet e ndalimit të gjykitimit.

5.3 Fshehja e shkakut përjashtues nga gjyqtarja në përbërje të Kolegjit Civil, e ka ndryshuar rrënjësisht rolin dhe funksionin e gjykatës në dhënien e drejtësisë, pasi gjyqtarës M.F. i mungon *a priori* bindja dhe paanshmëria, si element i procesit të rregullt ligjor.

5.4 Po ashtu, vendimmarrja nuk ka respektuar kërkesat e nenit 484 të KPC-së, që parashikon se vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, pasi nënshkrimi i gjyqtarës M.F. është i pavlefshëm.

6. **Subjekti i interesuar, Banka Kombëtare e Greqisë**, paraqiti me shkrim prapësimet e mëposhtme:

6.1 Procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës kanë filluar nga Banka NBG, duke konsideruar si shkak të arsyeshëm shkeljen e detyrimeve kontraktore dhe humbjen e besimit ndaj kërkuesit, në referim të parashikimeve të nenit 153 të Kodit të Punës. Kërkuesi, në mënyrë të qëllimshme, nuk i përmend detajet e mosmarrëveshjes me punëdhënësin, por ngre një “problem” procedural.

6.2 Kërkuesi, i cili ka qenë i pranishëm gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me përbërjen e Kolegjit Civil. Ndonëse ai ka qenë në dijeni të ekzistencës së kontratës së kredisë bankare, për të cilën ka dhënë vlerësime personale pozitive për shkak të pozicionit të punës, qëllimisht nuk e ka bërë të ditur faktin e pretenduar si shkak të njëanshmërisë së gjyqtarës M.F. në gjykim.

6.3 Kontrata e kredisë bankare midis gjyqtarës M.F. dhe bashkëshortit të saj, nga njëra anë, dhe NBG-së, nga ana tjetër, përbën një marrëdhënie institucionale kreditimi që nuk cenon asnjë të drejtë të kërkuesit, për vetë faktin se normat e kredisë janë të afishuara dhe publike për klientët. Po ashtu, nuk ka pasur trajtim preferencial për kredimarrësit, përkundrazi, norma e interesit të kredisë është rritur në datën 10.10.2009, pra përpara dhënies së vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### *A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë*

7. Kërkuesi ka pretenduar mosrespektimin e parimit të paanshmërisë gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, duke argumentuar se një nga anëtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit, ka qenë në kushtet e ndalimit të marrjes pjesë në seancën gjyqësore të shqyrtimit të rekursit, në referim të nenit 72, pika 3 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas kërkuesit, ekzistenca e kontratës së kredisë nr. 9238/2755, datë 15.10.2007 dhe kontratës së hipotekës nr. 9239/2756, datë 15.10.2007, të lidhur midis gjyqtarës M.F. dhe bashkëshortit të saj, nga njëra anë dhe NBG-së nga ana tjetër, fakt për të cilin ai ka marrë dijeni në përfundim të procesit gjyqësor dhe dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, përbën shkak objektiv të arsyeshëm për të besuar se gjykimi ka qenë i njëanshëm.

8. Subjekti i interesuar e ka prapësuar këtë pretendim të kërkuesit, duke argumentuar se ai ka qenë, paraprakisht, në dijeni të ekzistencës së kontratës së kredisë bankare për të cilën ka dhënë vlerësime personale pozitive për shkak të pozicionit të punës, por qëllimisht nuk e ka bërë të ditur faktin e pretenduar, si shkak të njëanshmërisë së gjyqtarës M.F., në gjykimin në Gjykatën e Lartë.

9. Gjykata, përpara se të shprehet mbi pretendimin e kërkuarit, çmon se duhet të vlerësojë bazueshmërinë e prapësimeve të subjektit të interesuar, NGB, në lidhje me shterimin e mjeteve nga ana e kërkuarit, në vështrim të nenit 131/f të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata, në referim të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon kushtet, kriteret dhe procedurat për përjashtimin e gjyqtarit (nenet 72-76), konstaton se “*procedura e dorëheqjes*” (neni 72), vihet në lëvizje nga gjyqtari që gjendet në kushtet e ndalimit, kurse “*procedura e përjashtimit*” (neni 74), iniciohet nga palët në proces. Në rastin e parë, KPC-ja parashikon se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara shprehimisht në nenin 72 të KPC-së, midis të cilave renditet edhe rasti kur “*ai/ajo vetë ose bashkëshortja e tij/saj janë në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve ose njërin prej përfaqësuesve*” (pika 3). Kërkesa për heqjen dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse, i cili merr vendim, ndërkohë që përmbajtja e kërkesës u njoftohet palëve. Në rastin e dytë, Gjykata konstaton se secila nga palët mund të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit në rastet kur dorëheqja e këtij të fundit është e detyrueshme. Kërkesa për përjashtimin nga pala e interesuar, duhet të paraqitet në sekretarinë e gjykatës ose menjëherë pas shpalljes së trupit gjykues që do të gjykojë çështjen. Po ashtu, kërkesa mund të paraqitet edhe më vonë, me kusht që pala të ketë marrë dijëni më vonë për shkakun e përjashtimit, por jo më vonë se tri ditë nga marrja dijëni.

10. Në vështrim të sa më sipër dhe, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, konkretisht procesverbali i seancës gjyqësore të datës 3.5.2012, Gjykata konstaton se kërkuari dhe mbrojtësi i tij kanë qenë të pranishëm dhe nuk kanë parashtruar kundërshtime lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Po ashtu, në dosje nuk gjendet e administruar ndonjë kërkesë për heqjen dorë nga ana e gjyqtarës M.F., paraqitur kryetarit të Gjykatës së Lartë, dhe as kërkesë e palës paditëse (kërkuarit) për përjashtimin e gjyqtarës M.F. nga përbërja e trupit gjykues. Madje, edhe në konkluzionet përfundimtare me shkrim të mbrojtësit të kërkuarit, të paraqitura gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, nuk parashtrohet asnjë argument lidhur me pretendimin e mësipërm.

11. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se, ndonëse subjekti i interesuar pretendoi pasjen dijëni, paraprakisht, të kërkuarit mbi ekzistencën e kredisë bankare për shkak të pozicionit të tij të punës pranë NBG-së, nuk paraqiti asnjë provë për të provuar këtë fakt. Për këto arsye, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuari i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, e vlerëson si të pabazuar prapësimin e subjektit të interesuar, NBG.

12. Duke iu rikthyer pretendimit të kërkuarit në lidhje me cenimin e parimit të paanshmërisë, Gjykata rithekson se ky parim nënkupton mungesën e paragjykimëve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërit prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen “Driza kundër Shqipërisë”, nr. 33771/02, datë 13.11.2007, §76*).

14. Në një çështje të ngjashme me atë në shqyrtim, GJEDNJ-ja, pasi ka analizuar fazat në të cilat ka kaluar zgjidhja e marrëveshjes së debisë midis bashkëshortit të një gjyqtareje të Gjykatës së Lartë me Bankën Kombëtare, ku kjo e fundit ka qenë palë e paditur në procesin gjyqësor të gjykuar prej



gjyqtares; po ashtu, pasi ka evidentuar veçoritë e procesit gjyqësor, veçanërisht kuorumin e vendimmarrjes në favor të Bankës Kombëtare me 3 vota pro (përfshi edhe gjyqtaren) dhe 2 kundër; duke nxjerrë në pah, si rezultat i kësaj analize, trajtimet preferenciale të Bankës Kombëtare ndaj bashkëshortit të gjyqtares, përfitimet e tij financiare, por edhe duke e vlerësuar marrëdhënien e debisë në një kontekst më të gjerë (*shih §§39-41*), ka arritur në përfundimin se: “Bazuar në sa më sipër, të paktën në dukje ekziston një lidhje midis hapave të marrë nga gjyqtarja në favor të bashkëshortit të saj dhe përfitimeve të tij nga Banka Kombëtare. Gjykata nuk do të spekulojë nëse gjyqtarja pati ndonjë përfitim personal nga veprimet në fjalë dhe, po ashtu, nuk gjen arsye për të besuar se ajo ose bashkëshorti i saj patën ndonjë interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes gjyqësore midis aplikantit dhe Bankës Kombëtare. Megjithatë, përfshirja e gjyqtares në zgjidhjen e marrëdhënies së debisë, përfitimet e marra nga bashkëshorti i saj dhe lidhjet e tij me Bankën Kombëtare ishin të një natyre dhe shpesh të tillë, dhe ishin kaq afër në kohë me procesin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, sa aplikanti mund të kishte frikë të arsyeshme se procesit i mungoi kërkesa për paanshmëri” (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen “Pétur Thór Sigurðsson kundër Islandës”, nr. 39731/98, datë 10.7.2003, §45*).

15. Në rastin konkret, Gjykata, nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuarit, vlerëson se respektimi i parimit të paanshmërisë në gjykim duhet të ekzaminohet nga këndvështrimi i testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse, të cilat ngjallin dyshim legjitim mbi njëanshmërinë e gjyqtares M.F. gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuari mbi njëanshmërinë e gjyqtares M.F., për shkak të ekzistencës së kontratës së kredisë bankare nr. 9238 Rep., nr. 2755 Kol., datë 15.10.2007 me Bankën NGB, është mjaftueshmërisht i provueshëm sa të cenojë në themel drejtësinë e vendimit të marrë në mënyrë unanime nga një koleg gjyqësor i përbërë nga pesë gjyqtarë.

16. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se gjyqtarët në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë vendosur, me unanimitet, lënien në fuqi të vendimit nr. 154, datë 3.2.2010 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin, midis të tjerash, se: “*Pretendimet e paraqitura në rekurs kanë të bëjnë me analizën e provave që ka bërë gjykata e apelit, prandaj ato nuk përbëjnë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 472 të KPC-së.*”

17. Po ashtu, nisur nga kushtet e kontratës së kredisë bankare, e cila nuk rezulton të ketë trajtuar në mënyrë preferenciale kredimarrësit (gjyqtaren M.F. dhe bashkëshortin e saj), bazuar në normën e interesit të kredisë, e cila nga norma fillestare 5.25 %, në vitin 2007, është rritur në 8%, në vitin 2009, me kontratën shtojcë të datës 10.10.2009, normë që vazhdon të zbatohet edhe sot, gjithashtu, në mungesë edhe të provave të paraqitura nga kërkuari mbi përfitimin e favoreve nga kredimarrësit për shkak të pozicionit të tyre apo të interesave kredimarrëse, Gjykata arrin në përfundimin se paanshmëria objektive e gjyqtares M.F. nuk lë shkas për dyshime dhe, për rrjedhojë, frika e kërkuarit mbi njëanshmërinë e saj gjatë procesit gjyqësor është e paarsyeshme dhe dyshimi i tij nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese.

18. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, nuk duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të dalim me mendim pakice.

Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka konkluduar se paanshmëria objektive e gjyqtarës M.F. nuk lë shkas për dyshime dhe, për rrjedhojë, frika e kërkuarit mbi njëanshmërinë e saj gjatë procesit gjyqësor është e paarsyeshme dhe dyshimi i tij nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese (*shih paragrafin 17 të vendimit*). Për pasojë, shumica nuk e ka pranuar pretendimin e kërkuarit në lidhje me cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës.

Nuk pajtohem me këto përfundime, ndaj në vijim do të parashtrojmë argumentet për qëndrimin tonë, të ndryshëm nga ai i shumicës.

Shumica, në çështjen konkrete, bazuar në standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, e ka vlerësuar respektimin e parimit të paanshmërisë në gjykim nga këndvështrimi i testit objektiv, që nënkupton verifikimin e ekzistencës së fakteve bindëse, të cilat ngjallin dyshim legjitim mbi njëanshmërinë e gjyqtarës gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë (*paragrafi 15 i vendimit*). Ajo u është referuar dispozitave procedurale civile, konkretisht, ndër të tjera, nenit 72/3 të KPC-së, i cili sanksionon, si një nga shkaqet kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i çështjes, rastin kur ai/ajo vetë, ose bashkëshortja e tij/saj janë në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve (*prg. 9 i vendimit*). Për pretendimin e ngritur në lidhje me cenimin e parimit të paanshmërisë, shumica, pasi ka konstatuar se nuk rezulton që kontrata e kredisë bankare të ketë trajtuar në mënyrë preferenciale gjyqtaren, si kredimarrëse, dhe mungesën e provave të paraqitura nga kërkuari në lidhje me përfitimin e favoreve nga ana e saj, për shkak të pozicionit, ka arritur në konkluzionin, ndër të tjera, se dyshimi i kërkuarit nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar (*prg. 17 i vendimit*).

Në ndryshim nga shumica, çmojmë se, në rastin konkret, ka vend për dyshime të arsyeshme dhe mjaftueshmërisht të bazuara, në drejtim të cenimit të paanshmërinë së gjykatës, në aspektin objektiv. Gjykata, në praktikë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit, i cili ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues. Gjykatat duhet të jenë të kujdesshme dhe të marrin parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanojnë nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri objektive. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast, në shoqërinë demokratike, jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë. Ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjykimit duhet të jetë pasiv dhe *super partes* (*shih vendimet nr. 11, datë 5.4.2013 dhe nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në një çështje të ngjashme me rastin konkret, të cilës i është referuar edhe shumica, GJEDNJ-ja ka nënvizuar se, sipas testit objektiv, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit. Për pasojë, çdo gjyqtar, ndaj të cilit ekziston një arsye legjitime që krijon dyshim në drejtim të mungesës së paanshmërisë, duhet të dorëhiqet. Vendimtare është nëse ky dyshim





mund të konsiderohet si objektivisht i justifikuar (*shih Pétur Thór Sigurðsson kundër Islandës, aplikimi nr. 39731/98, datë 10.7.2003; § 37*). Më tej, po në këtë çështje, pasi ka vlerësuar se kontributi financiar për pagimin e borxhit të të shoqit ndaj bankës ishte i konsiderueshëm dhe i domosdoshëm (§42) GJEDNJ-ja ka konkluduar (§ 45) se “përfshirja e gjyqtarës në pagimin e borxhit, favorët e përfituara nga bashkëshorti i saj dhe lidhjet e tij me bankën ishin të një natyre dhe shkalle të tillë dhe ishin aq afër në kohë me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, sa që aplikanti mund të kishte dyshime të arsyeshme se asaj i mungonte paanshmëria e nevojshme (*shih, mutatis mutandis, Holm kundër Suedisë, gjykimi i 25 nëntor 1993, Seria A nr. 279-A, fq 15-16, § § 32-33*).

Në rastin në shqyrtim, nga të dhënat faktike, rezulton se gjyqtarja është në marrëdhënie kredie me subjektin e interesuar (NBG), sipas kontratës së kredisë bankare nr. 9238 Rep., nr. 2755 Kol., datë 15.10.2007. Vlera e kredisë, objekt i kësaj kontrate, përbën një shumë substancialisht të konsiderueshme, e cila nuk mund të mos merret parasysh në këndvështrim të raportit që ekziston midis gjyqtarës dhe NBG-së, si dhe të interesave reciproke të tyre për shkak të kësaj marrëdhënieje kredie. Nuk mund të përjashtohet kategorikisht gjendja e gjyqtarës përpara një lloj presioni në gjykimin e çështjes, si pasojë e marrëdhënies së kredisë, shumave të konsiderueshme të kredisë së marrë dhe asaj të pushyer ende në kohën e gjykimit, faktorë të cilët nuk mund të neglizhohen në këtë rast. Për këto arsye, dyshimi i kërkuesit se trupi gjykues nuk ka ofruar garanci në drejtim të paanshmërisë në gjykim, është i përligjur nga pikëpamja objektive.

Bazuar në sa më sipër, çmujmë se, në rastin në shqyrtim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së tij për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, në aspektin objektiv, është i bazuar, ndaj dhe kërkesa e tij duhet të pranohet nga Gjykata.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

## VENDIM

Nr. 42, datë 10.10.2013

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtar e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 18.7.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 18 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Hyrije Gavoçi, Petrit Gavoçi, Diana Gavoçi, përfaqësuar nga av. Hydajete Kundraxhi, me prokurë të posaçme.

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** Fedhon Meksi, përfaqësuar nga av. Avni Shehu, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 562, datë 6.12.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 4, 15, 41/1, 42, 131/f, 134/1 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha, përfaqësuesen e kërkuesve që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e përfaqësuesit të subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit kanë qenë qiramarrës të një shtëpie banimi në Tiranë. Në vitin 1992, pas hyrjes në fuqi të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, ata kanë filluar përgatitjen e dokumentacionit për ta paraqitur në Ndërmarrjen e Komunale-Banesave (NKB), por, për arsye personale, kërkuesit janë larguar jashtë shtetit, duke humbur afatin e parashikuar nga ligji për privatizimin.

2. Në vitin 1999 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për rivendosje në afat, e cila është pranuar me vendimin gjyqësor nr. 3240, datë 8.11.1999, që parashikon në dispozitiv edhe detyrimin e NKB-së për të privatizuar banesën.

3. Vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga shtetasi F.M., i cili i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt “Kundërshtimi i të tretit ndaj vendimit nr. 3240, datë 8.11.1999”, duke pretenduar se sipas regjistrit hipotekor nr. 75, datë 9.2.1929, si trashëgimtar i V.M., ai ka në pronësi një truall prej 1100 m<sup>2</sup>, mbi të cilin, në vitin 1942, Ministria e Punëve Botore ka nxjerrë në emër të trashëgimlënësit të tij një leje për ndërtimin e një banese dykatëshe. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar se personit të tretë i janë prekur të drejtat e pronësisë, me vendimin nr. 1371, datë 5.5.2000, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

4. Kundër vendimit të mësipërm kërkuesit paraqitën ankim në Gjykatën e Apelit, e cila, me vendimin nr. 96, datë 1.2.2001, ka vendosur ndryshimin e vendimit të kundërshtuar, me arsyetimin se shtetasi F.M. legjitimohej t’i drejtohej gjykatës vetëm nëse do të dispononte një vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që provon titullin e pronësisë mbi pronën e pretenduar.

5. Në vitin 2011, shtetasi F.M. ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 1371, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtuar si shkak rishikimi zbulimin e disa provave të reja që nuk dihehin prej tij në kohën e shqyrtimit të çështjes. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 562, datë 6.12.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë, me tjetër trup gjykues.

6. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 21.2.2013, me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

6.1 Gjykata e Lartë ka cenuar *të drejtën e mbrojtjes në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi nuk ka respektuar kërkesat procedurale për njoftimin e palëve në procesin civil, në kundërshtim me nenet 442 dhe 447 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata e Lartë, pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, nuk ka marrë masa për njoftimin e palëve të cilat, duke qenë se jetojnë jashtë shtetit, efektivisht nuk kanë mundësi të marrin dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor. Po ashtu, rezulton se mungon njoftimi edhe për Ndërmarrjen e Komunale-Banesave. Dijenia për zhvillimin e procesit gjyqësor ka qenë e rastësishme nga ana e përfaqësueses ligjore të kërkuesve në proceset e mëparshme. Për këtë arsye, në procesin gjyqësor është përfaqësuar vetëm Hyrije Gavoçi, kurse Petrit dhe Diana Gavoçi nuk kanë qenë të pranishëm për shkak të mosnjoftimit.

6.2 Është cenuar *parimi i paanshmërisë*, pasi gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë nuk janë pranuar të administrohen dhe as janë marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga mbrojtësja e Hyrije Gavoçit.

6.3 Gjykata e Lartë ka cenuar *parimin e sigurisë juridike*, pasi duke pranuar kërkesën për rishikim tej afatit prekluziv 1-vjeçar nga dita kur ka lindur shkak i rishikimit, ka vënë në dyshim vlerën e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Po ashtu, shkresat që janë paraqitur nga kërkuesi si prova të reja, jo vetëm kanë qenë në dispozicion të tij nga viti 1999 deri në vitin 2011, por ato nuk plotësojnë kërkesat e provës së re, në kuptim të nenit 494/a të KPC-së.

7. **Subjekti i interesuar, Fedhon Meksi**, ka parashtuar këto prapësime:

7.1 Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike, pasi procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, me objekt rishikimin e vendimit, nuk është përfundimtar. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente të shqyrtojë kërkesën e paraqitur, pa përfunduar procesi gjyqësor në të gjitha shkallët.





7.2 Në lidhje me themelin e kërkesës, pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara. Ata kanë qenë të pranishëm në të dyja seancat gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Lartë, madje u janë vënë në dispozicion edhe provat, fakt që provohet edhe nga vendimi i Kolegjit Civil.

7.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për faktin se ky parim është i lidhur me gjykime të drejta dhe jo të padrejta ashtu si procesi gjyqësor i privatizimit të banesës në favor të kërkuësve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor nuk ka respektuar parashikimet e ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i cili në nenin 21 ndalonte në mënyrë kategorike privatizimin e banesave të ish-pronarëve.

7.4 E drejta e pronësisë së ish-pronarëve ka prioritet ndaj të drejtave të njohura individëve nga Kushtetuta përpara hyrjes në fuqi të saj. Në rast se për kthimin e pronave ish-pronarëve afati njëvjeçar do të lidhej me ekzistencën e provave, atëherë mundësia e kthimit të pronave të tyre do të ishte e pamundur. Në këtë kuptim, ushtrimi i mjetit të rishikimit me një afat të pamundur është antikushtetues.

7.5 Edhe pretendimi i kërkuësve mbi provat është i pabazuar, pasi ato janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe kanë qenë prova të reja që konfirmojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën.

## II

### *Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese*

8. Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuësve, të parashtruara në kërkesë dhe gjatë seancës plenare me dyer të hapura nga përfaqësuesja me prokurë të posaçme, kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në drejtim të mosrespektimit të së drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të paanshmërisë dhe të sigurisë juridike.

9. Gjykata, pas marrjes në shqyrtim të pretendimeve të kërkuësve dhe të prapësimeve të subjektit të interesuar, ia nënshtroi ato procesit të votimit, por nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj<sup>1</sup>, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 133/2 të Kushtetutës dhe në nenin 72/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Në kushtet kur, gjatë votimit të çështjes, votat u ndanë në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk arriti të votohej nga shumica e kërkuar, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet refuzuar. Në referim të nenit 74 të ligjit organik, refuzimi i kërkesës për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm të votave, nuk përbën pengesë që kërkuësit të riparaqesin kërkesën, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, germa “f”, nenit 134, pika 1, germa “g”, nenit 133/2 të Kushtetutës; neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

### VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha

<sup>1</sup> Votuan për pranimin gjyqtarët: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari.

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 17.10.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtar e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtar e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 16.7.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 23 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Klaudio Ligori

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shoqëria e Përmbarimit “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k.

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pika 1, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 27, 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuarit, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi Klaudio Ligori për periudhën prej vitit 1999 deri në datën 1.2.2010 ka kryer detyrën e specialistit në Drejtorinë e Hetimit, Departamenti Operativ dhe Hetimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me vendimin nr. 352/7 prot., datë 26.1.2010, ka marrë masën disiplinore ulje një shkallë në kategori, nga C1 në C2, dhe transferimin nga pozicioni i punës, për një periudhë 1-vjeçare, në degën e Doganës, Vlorë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010, ka vendosur: Pranimin e kërkesëpadisë së kërkuarit për anulimin e vendimit nr. 352/7 prot, datë 26.1.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave; rikthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës; detyrimin e palës së paditur/subjekti i interesuar t’i paguajë paditësit/kërkuesit diferencën e pagës nga data 27.1.2010 deri në datën 4.5.2010 si specialist në Drejtorinë e Hetimit, kategoria C1; detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit pagën prej datës 4.5.2010 deri në momentin e kthimit në vendin e mëparshëm të punës si specialist në Drejtorinë e Hetimit, kategoria C1.



4. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011, plotësuar me vendimin nr. 466, datë 25.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 2399, datë 15.11.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të subjektit të interesuar.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3523, datë 8.3.2012, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Kërkuesi, në datën 27.7.2012, i është drejtuar me shkresë shoqërisë përmbartimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k. për të filluar procedurat e ekzekutimit.

8. Shoqëria përmbartimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., me shkresën nr. 5271 prot., datë 27.7.2012, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Njoftimi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka vijuar me shkresat nr. 5431 prot., datë 2.8.2012 dhe nr. 2050 prot., datë 22.2.2013.

9. Gjatë periudhës së zhvillimit të procesit gjyqësor për anulimin e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për masën disiplinore të uljes në detyrë, me shkresën nr. 5844 prot., datë 4.5.2010, kërkuesi ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga puna në degën e doganës Vlorë.

10. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me vendimin nr. 5839/5 prot., datë 17.5.2010, ka vendosur largimin nga puna të kërkuesit nga dega e doganës Vlorë.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2335, datë 12.3.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, si dhe anulimin e vendimit nr. 5839/5 prot., datë 17.5.2010, për largimin nga puna.

12. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2122, datë 18.9.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2335, datë 12.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13. Mbi rekursin e subjektit të interesuar kundër vendimit nr. 2122, datë 18.9.2012 të Gjykatës së Apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) me vendimin nr. 317, datë 15.2.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit.

14. Në të njëjtën periudhë, subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. 12262/3 prot., datë 16.8.2012, i është drejtuar Gjykatës së Lartë duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010, lënë në fuqi me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit, i plotësuar me vendimin nr. 466, datë 25.10.2011. Për këtë vendim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit. Pas kësaj kanë filluar procedurat e ekzekutimit.

## II

15. **Kërkuesi**, në datën 30.4.2013, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, pika 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

16. **Subjekti i interesuar**, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur duke argumentuar:

16.1. Në çështjen në shqyrtim nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për më tepër kërkesa rezulton të jetë pa objekt. Kërkuesi pretendon ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë vendosur në lidhje me anulimin e aktit të transferimit dhe uljes në kategori. Ndërkohë kërkuesi është larguar nga puna, duke iu ndërprerë marrëdhëniet e punës. Në këto kushte, vendimi i gjykatës, për rikthimin në pozicionin e mëparshëm, nuk duhet të zbatohet.

16.2. Vendimi objekt kërkesë do të ishte i mundshëm për t'u ekzekutuar nëse kërkuesi do të ishte në marrëdhënie pune. Pasojat e një akti administrativ janë në varësi të asaj që ka përcaktuar akti. Pavlefshmëria e një akti i çon palët në gjendjen e mëparshme. Pavlefshmëria e transferimit e çon kërkuenin në pozicionin e mëparshëm dhe pavlefshmëria e largimit nga puna e çon atë në vendin e punës në degën e Doganës Vlorë.

16.3. Pozicioni i punës ku pretendon kërkuesi të kthehet, nuk ekziston më në organikën aktuale të Drejtorisë së Hetimit.

17. *Subjekti i interesuar*, shoqëria përmbarimore "Strati Bailiff's Service" sh.p.k., nuk ka paraqitur parashtrime lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës*

18. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

19. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

20. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuetit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata Kushtetuese, në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

#### *i) Kompleksiteti i çështjes*

22. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuetit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.



*ii) Sjellja e kërkesit*

23. Për sa i përket sjelljes, veprimeve të kërkesit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave rezultojnë se kërkesi, pas mbarimit të procesit gjyqësor për anulimin e vendimit për masën disiplinore të uljes në detyrë dhe transferimit, në datën 27.7.2012, i është drejtuar shoqërisë përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k. me kërkesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

24. Sa më sipër, kërkesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

*iii) Sjellja e autoriteteve*

25. Në këtë drejtim, është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k. ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura, rezultojnë se shoqëria përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k. është mjaftuar me lajmërimin për ekzekutim vullnetar nr. 5271 prot., datë 27.7.2012; ka dërguar në vazhdimësi shkresat me nr. 5431 prot., datë 2.8.2012 dhe nr. 2050 prot., datë 22.2.2013, por nuk ka ndërmarrë hapat e mëtejshëm proceduralë të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi.

26. Në lidhje me sjelljen e autoritetit tjetër, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pasi vendimi ka marrë formë të prerë, ky autoritet nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta ekzekutuar. Kjo drejtori, me shkresën nr. 12262/3 prot., datë 16.8.2012, drejtuar Gjykatës së Lartë, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010, lënë në fuqi me vendimin nr. 1624, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit, i plotësuar me vendimin nr. 466, datë 25.10.2011. Në këtë shkresë ka parashtruar se ekzekutimi i këtij detyrimi do t’i sillte buxhetit të shtetit një dëm efektiv dhe të pariparueshëm.

27. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar se kërkesa, objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, ka mangësi në objekt pasi ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, objekt i kërkesës, lidhet me transferimin nga detyra të kërkesit, në një kohë kur kërkesi ishte larguar nga detyra, Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim është i pabazuar.

28. Nga materialet e ndodhura në dosje rezultojnë se vendimi i Drejtorisë së Doganave, për largimin nga detyra, ka dalë në një kohë kur kërkesi ishte në proces gjyqësor për vendimin e transferimit dhe uljes në detyrë. Rezultojnë se para daljes së vendimit të largimit, me shkresën nr. 5844 prot., datë 4.5.2010, kërkesi ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga detyra si doganier në degën e Doganës Vlorë. Bazuar në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, subjekti i interesuar nuk mund të nxirrte aktin e detyrës të largimit nga detyra, në një kohë kur kërkesi nuk ishte në marrëdhënie pune, çka e bën aktin e largimit nga puna të pavlefshëm. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka pasur për detyrë të zbatojë pasojat juridike të vendimit gjyqësor me objekt anulimin e vendimit të transferimit nga pozicioni i punës së kërkesit. Në kushtet kur pasojat juridike nuk ishin rregulluar, nuk mund të nxirrte një akt të detyrës për largimin nga detyra.

29. Gjithashtu, i pabazuar është dhe pretendimi se vendimi nuk mund të ekzekutohet pasi vendi i punës nuk ekziston më në organikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012 dhe nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Lidhur me afatet kohore, në çështjen konkrete rezultojnë se urdhri i ekzekutimit, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mban datën 8.3.2012. Gjykata çmon se megjithëse *prima facie* nuk rezultojnë të jetë një afat i tejzgjatur kohor, nisur nga tërësia e rrethanave të çështjes, debitori (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), ka pasur kohën e mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj kreditorit/kërkesit. Debitori jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por vazhdon të shprehet se nuk do të kryejë veprimet e duhura në plotësim të detyrimeve të tij ndaj kreditorit. Gjykata vëren, gjithashtu, se

edhe organi përgjegjës i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, shoqëria përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” sh.p.k., nuk i ka marrë të gjitha masat përkatëse në drejtim të zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor. Nuk rezulton që sjelljet e kërkuarit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, përkundrazi ai ka qenë aktiv në kërkimin e tij për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar.

32. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, dhe brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 5945, datë 16.7.2010, i plotësuar me vendimin nr. 345 akti, datë 30.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Vendosur, Tiranë, më 16.7.2013

Shpallur, Tiranë, më 17.10.2013



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 27 lekë